




Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RREGULLORE PËR MARKETING NË OSK

Prishtinë, prill 2022

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TE KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, dhe Nenin 20 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OSK-së, në mbledhjen e datës 06.04.2022, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR

MARKETING NË OSK

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat, kushtet e procedurat për dhënie të hapësirës për marketing (reklama) në Odën e Stomatologëve të Kosovës.

Neni 2

Këshilli Drejtues i OSK-së në koordinim me zyrtarin për çështje marketingu dhe këshillin redaktues të Revistës përcaktojnë hapësirën dhe mundësinë e lejitimit të aktivitetit komercial.

Neni 3

Përkufizimi i shprehjeve

1. **OSK**- nënkupton Odën e Stomatologëve të Kosovës.
2. **Këshilli Drejtues**- nënkupton organin udhëheqës të Odës së Stomatologëve të Kosovës
3. **Marketing** – nënkupton aktivitetin komercial dhe shërbimet e marketingut.
4. **Web-faqe** – nënkupton Web-faqen zyrtare të Odës së Stomatologëve të Kosovës ku ofrohen shërbimet e marketingut (www.osk-ks.org)

5. **Revista e Stomatologëve të Kosovës** – nënkupton Revistën në të cilën përveç publikimeve nga shkenca mjekësore, ofrohen mundësia e publikimit të reklamave sipas kërkesave.
6. **Shërbimet komerciale** – nënkupton menagjimi dhe kushtet e lejimit të aktivitetit komercial të marketingut.
7. **Hapësira reklamuese** – nënkupton hapësirën e lejuar për aktivitet komercial.
8. **Çmimorja** – nënkupton listën me çmime për shërbimet e ofruara.
9. **Reklamuesi** – nënkupton individin apo biznesin i cili bën kërkesë për shfrytëzim të hapësirës reklamuese.

Neni 4

1. Këshilli Drejtues i OSK-së themelon Komisionin Vlerësues prej së paku tre (3) anëtarëve të cilët e bëjnë vlerësimin e kërkesës së reklamuesit, dhe i japin rekomandim me shkrim Këshillit Drejtues, i cili me pas nxjerr vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës.
2. Këshilli Drejtues rezervon të drejtën për ndryshimin e çmimeve në rastet kur paraqiten kërkesa të veçanta për marketing.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues është vendim përfundimtar ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet e drejta në ankesë.

Neni 5

OSK-ja obligohet t'i kryej shërbimet e publikimit (transmetimit) të reklamave sipas porosisë së pranuar nga reklamuesi në bazë të kontratës dhe pagesës.

Neni 6

Nëse reklamuesi nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet në bazë të kontratës së lidhur, OSK-ja ka të drejtë që të ndërpresë transmetimin e reklamës së porositur.

Neni 7

1. OSK-ja në përputhje me kushtet e dhënies së hapësirës reklamuese lidh kontratë me zbritje (ulje çmimesh) në rastet kur kontrata lidhet për dy shërbime promovimi.
2. Reklamat ndahen në këto kategori:
 - 2.1. Web-faqe (web page)
 - 2.2. Revista
 - 2.3. Web-faqe dhe Revista
 - 2.4. Forma tjera të komunikimit

Neni 8

Kontratën, reklamuesi e lidhë me Odën e Stomatologëve të Kosovës, gjegjësisht me Kryetarin e saj, ndërsa asistenca administrative ofrohet nga zyrtari përgjegjës për çështje marketingu.

Neni 9

Oferta për reklamë

1. Oferta për reklamë përpilohet në përputhje me kriteret e parapara për reklamë.
2. Të gjitha ofertat, pakot, informatat shitesë dhe ndryshimet në lidhje me reklamim në Web-faqen zyrtare dhe Revistë, procesohen nga zyrtari për çështje marketingu, aprovohen nga Kryetari i OSK-së dhe pastaj publikohen.
3. Krahas ofertave të rregullta, publikohen edhe oferta të veçanta për reklama dhe sponzorizim.
4. Për format e mundshme të reja të reklamës dhe për ngjarje të veçanta, OSK publikon thirrje për oferta reklamuese në çastin e fundit.

Neni 10

Porosia e reklamës

1. Porositë për reklama pranohen nga zyrtari për çështje marketingu pranë OSK-së.
2. OSK-ja pranon reklamën drejtpërdrejt nga reklamuesi me postë apo në mënyrë elektronike si dhe formave tjera të komunikimit. Është e domosdoshme që të gjitha

porositë para publikimit të reklamës, reklamuesi t'i konfirmoj përmes postës elektronike tek zyrtari për çështje marketingu.

3. Nëse zyrtari përgjegjës për marketing pranë OSK-së nuk e pranon një konfirmim të tillë të porosisë më së voni deri në ditën në të cilën do të publikohet porosia/reklama, për OSK-në ekzekutimi i porosisë nuk është i obligueshëm.
4. Zyrtari për marketing nëse vlerëson se reklama/porosia e reklamuesit nuk i përmbahet kriterëve dhe rregullave për reklamim në Web-faqen zyrtare të OSK-së dhe në Revistë, reklama do të refuzohet..

Neni 11

Refuzimi i reklamës

1. OSK-ja do të bëjë refuzimin e reklamave në këto raste:
 - 1.1 Nëse reklama ka përmbajtje politike,
 - 1.2 Nëse përmbajtja e reklamës bie ndesh me ligjin për shëndetësi, ligjin për OPSH-të, statutin e OSK-së, dhe aktet tjera nënligjore të OSK-së,
 - 1.3 Në rast se hapësira reklamuese nënkontraktetohet nga kontaktuesi (reklamuesi) pa dijeninë dhe lejen e OSK-së.

Neni 12

Përgjegjësitë e OSK-së dhe reklamuesit

1. OSK-ja është e obliguar që:
 - 1.1 Të publikojë reklamën gjatë kohës, siç është përcaktuar me kontratë,
 - 1.2 Të kthejë shumën për reklamë, në rast të mospublikimit të reklamës sipas kushteve të përcaktuara paraprakisht.
2. OSK-ja nuk mban kurrfarë përgjegjësie lidhur me vërtetësinë e pohimeve të reklamuesit.
3. Përgjegjësinë për vërtetësinë e pohimeve të reklamave e mban në tërësi reklamuesi.
4. Të gjitha njoftimet, shpalljet apo reklamat, reklamuesi është i obliguar t'i bashkangjes informacionet në të cilat duhet të jenë theksuar:
 - 4.1. emri i shpalljes, njoftimit apo reklamës, sasia e materialit, renditja,
 - 4.2. kohëzgjatja e saktë e shpalljes, njoftimit apo reklamës.

Neni 13

Çmimi i reklamave

1. Çmimi i reklamës në hapësira të caktuara reklamuese, është i caktuar në çmimoren vjetore për reklama, si dhe në ofertat mujore dhe ofertat e veçanta për reklamim.
2. Këshilli Drejtues i OSK-së ka kompetencë për të aprovuar çmimoren si dhe bëjë plotësim/ndryshimin e saj sipas nevojave, për arsye operationale shkaktuar nga luhatjet në çmime dhe organizimit të hapësirave reklamuese.

Neni 14

Reklamimi pa pagesë

1. Per rastet pa pagesë vendos Këshilli Drejtues i OSK-së, në bazë të kërkesës së reklamuesit..
2. Reklamimi pa pagesë bëhet me Marrëveshje Mirëkuptimi dy palëshe (OSK-Reklamuesi).

Neni 15

Kontrata

1. Në përputhje me dispozitat e kushteve të dhënjes së hapësirës reklamuese sipas kësaj rregulloreje, OSK-ja mund të lidhë kontratë me reklamues te drejtpërdrejt, agjensione, institucione, organizata, etj.
2. Zyrtari për çështje marketingu pranë OSK-së, së bashku me zyrën ligjore, është përgjegjës për vlerësimin e kontratave dhe dhënjen e rekomandimit rreth tyre tek Kryetari i OSK-së, i cili pas aprovimit bën nënshkrimin e kontratave për hapësirë reklamuese me reklamuesin.
3. Kontrata përpilohet bazuar në dispozitat e kësaj Rregulloreje
4. Afati kohor i kontratës mund të vazhdohet kur kemi kërkesa të specifikuara nga reklamuesi, të cilat do të shqyrtohen dhe do të aprovohen apo refuzohen me vendim nga Këshilli Drejtues.
5. Hapësira reklamuese e kontraktuar nuk lejohet të nënkontraktohet.

Neni 16
Pagesat për shërbime

1. OSK-ja i'a dorëzon reklamuesit faturën për reklamën e porositur dhe rezervon të drejtën që reklamuesve të cilët nuk i kryejnë obligimet kontraktuale, të mos iu ofrojë shërbim deri në shlyerjen e të gjitha obligimeve.
2. OSK-ja rezervon të drejtën që reklamuesve të cilët nuk i përmbahen marëdhënies kontraktuale për shërbimin e marketingut t'ua diskualifikojë kërkesat për reklamimin në të ardhmen.
3. Afatet e pagesës dhe kushtet e tjera të pagesës për reklamuesin me kontratë të lidhura janë të përcaktuara me kontratë.

Neni 17
Reklamimi

1. OSK-ja pranon ankesën për reklamën e publikuar në webfaqe (me gabime teknike) më së largu 10(dhjetë) ditë pas publikimit të reklamës.
2. OSK-ja nuk është i obliguar t'i shqyrtojë ankesat që arrijnë pas afatit të parapare ligjor.
3. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues, dhe ndaj vendimit të tij nuk mund ti atakohet me procedurën e ankimit.

Neni 18
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë të miratimit.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën kur miratohet nga Kuvendi i OSK-së dhe kur nënshkruhet nga Kryetari i OSK-së.

Prishtinë,

06.04.2022

Kryetar i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi



SHTOJCA 1

ÇMIMORE MARKETINGU PËR WEBFAQE TË OSK-SË DHE PËR REVISTË

I. Hapësirat reklamuese në webfaqen zyrtare janë të ndara në tre pozicione:

Pozicioni 1: Baner 970x250 px

Pozicioni 2: Baner footer 970x250 px

Pozicioni 3: Baner 300x250 px

Pozicioni 1: Baner

Në Pozicionin 1 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e sipërme të ballinës së faqes, me dimensione 970x270 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	200€
3 muaj	550€
6 muaj	800€
1 vjet	1200€



Pozicioni 2. Baner footer

Në pozicionin 2 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e poshtme të ballinës së faqes, me dimensione 970x270 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	150€
3 muaj	250€
6 muaj	400€
1 vjet	700€




Pozicioni 3. Baner

Në pozicionin 3 është mundësia e shfaqjes së hapësirës reklamuese në pjesën e sipërme të ballinës në faqe, me dimensione 300x250 px.

Çmimi për këtë pozicion është:

Kohëzgjatja	Çmimi
1 muaj	100€
3 muaj	150€
6 muaj	€400
1 vjet	600€



II. Hapësirat reklamuese në Revistë janë të ndara në këto pozicione:

1. Pjesa e brendshme e faqes së parë të kopertinës – 1000 €
2. Pjesa e brendshme e faqes së fundit të kopertinë - 800 €
3. Faqja e plotë brendshme e revistës – 500€
4. ½ e faqes së brendshme të revistës – 350€
5. ¼ e faqes së brendshme të revistës – 200 €